



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE E UJËSJELLËS – KANALIZIME FIER SH.A

Nr. _____ prot

Fier, më ____/____/2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**
(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Sherbim Mirembajtje i sistemit te Sigurise dhe Monitorimit te Burimeve Ujore dhe Depove te Ujit Shoqerise Rajonale Ujesjelles Kanalizime.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): *sherbime riparimi dhe mirembajtje te pajisjeve te sigurise.*

VLERA E FONDIT LIMIT : 13.541.667 *(trembedhjete milion e peseqind e dyzete e nje mije e gjashteqind e gjashtedhjete e shtate) Lekë pa TVSH.*

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Fier ShA, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: *Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar. Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për*

pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

- Sipas Shtojcës Nr. 9

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.*

2.1.1. Te jete i specifikuar ne QKB objekti i veprimtarise se operatorit ekonomik i njejte ose ekuivalent me objektin e prokurimit.

- **Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.9 per ato pika te cilat mund te plotesohen me ane te Vetdeklarimit sipas Ligjit.**
- **Operatori ekonomik fitues duhet te dorezoje prane AK, perpara lidhjes se kontrates, te gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.**

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.*

Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 30% vlerës** së përllëgaritur e kontratës që prokurohet.

2.2.2 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023, 2024, 2025) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të një pasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Shëmin: *Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar.*

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për vitin **2026** (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar), duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e qeverisjes vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar sipas vlerës së fondit limit të kësaj procedure, sipas nenit 77, pika 3, të ligjit nr. 162/2020, si dhe neneve 43 dhe 47, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me qëllim që autoriteti kontraktor të kuptojë nëse operatorët ekonomikë ofertues kanë apo zotërojnë mundësitë e nevojshme financiare për të përmbyllur punët publike me sukses. Xhirot e tre viteve të fundit janë 2023, 2024, 2025, që rezultojnë të jenë përmbyllur edhe sipas legjislacionit tatimor. Përqindja e kërkuar mbi xhiron vjetore është një përqindje minimale sipas RRPP-ve dhe xhiro e tre vjetëve e kërkuar, jo vetëm që përputhet me praktikën administrative të prokurimeve publike të ndjekur deri më tani, por është e rëndësishme për të vlerësuar kapacitetin ekonomik të ofertuesit dhe kuptuar nëse është i aftë financiarisht për të përmbyllur punët publike pranë autoritetit kontraktor. Po kështu, që nga operatorët ekonomikë të vërtetohet kapaciteti ekonomik, ata mund të paraqesin kopje të bilanceve të tre viteve të fundit për vitet 2023, 2024, 2025, si mbas xhirove vjetore, të depozituar pranë autoriteteve përkatëse tatimore, të konfirmuara nga ky autoritet, sipas ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, të ndryshuar. Paraqitja e bilanceve është një mundësi, në rast se operatori ekonomik ofertues paraqet xhirot e kërkuara. Këto kërkesa të vendosura në DST (për mundësinë e paraqitjes së bilanceve dhe detyrimin e paraqitjes së dokumenteve për xhiron vjetore) përputhen edhe me nenin 9 të ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”, të ndryshuar, sipas të cilëve periudha e raportimit financiar është 12 muaj dhe periudha e depozitimit të pasqyrave financiare është nga 12-15 muaj.

Gjithashtu, për të vërtetuar kapacitetin ekonomik, operatori ekonomik ofertues duhet të depozitojë vërtetim që konfirmon shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga pushteti lokal për tre vitet e fundit, në të gjitha njësitë e qeverisjes vendore ku ai ushtron aktivitetin sipas të dhënave përkatëse të ekstraktit të QKR-së/QKB-së. Kjo kërkesë buron nga neni 76 i LPP-së, ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, si dhe ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, sipas të cilëve subjektet tregtare kanë detyrimin që të paguajnë taksat vendore, me qëllim që të ushtrojnë aktivitetin. Vitet përkojnë me 2023, 2024, 2025. Të gjitha kërkesat lidhur me kapacitetin ekonomik janë të bazuara në legjislacionin e përmendur më sipër dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse ofertuesit kanë kapacitete për të nisur dhe përfunduar punët publike që prokurohen. Po kështu, duke qenë se mund të marrin pjesë si ofertues edhe bashkime operatorësh ekonomikë, atëherë secili prej operatorëve ekonomikë të bashkuar, duhet të depozitojë dokumentacionin si më lart. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke i'u referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”; si dhe shkronjës c, të nenit 41 të ligjit nr. 10091, datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, ku parashikohet se: “Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: ... c) shoqëritë me përgjegjësi të

kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i. totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii. ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël.”. Po kështu, kjo kërkesë bazohet edhe në udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, me një vlerë **jo më të vogël se 30% e vlerës së përlogaritur** të objektit që prokurohet.

- a) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të

deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.

- b) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.

Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtyre kritereve kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 30 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose në vlerën limit të kontratës për punët totale të ngjashme të kryera në 3 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar. Këto vlera janë vlerat minimale të kërkuara sipas RRPP-ve. a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratën e shërbimit; vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës; Situacion Përfundimtar dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, i shërbejnë autoritetit kontraktor për të kuptuar nëse ofertuesi ka qenë i angazhuar në veprimtari ndërtimore të ngjashme, i ka përmbyllur me sukses këto punë, si dhe ka kapacitet teknik për të përmbyllur punët që prokurohen nga autoriteti kontraktor. b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratë Shërbimi dhe fatura

tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, i shërbejnë autoritetit kontraktor për të kuptuar nëse ofertuesi ka qenë i angazhuar në veprimtari ndërtimore të ngjashme pranë subjekteve private, i ka përmbyllur me sukses këto punë, si dhe ka kapacitet teknik për të përmbyllur punët që prokurohen nga autoriteti kontraktor. Dokumentet e mësipërme janë të mbështetura edhe në legjislacionin në fuqi të zbatueshëm për ndërtimet. Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet, që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE. Kjo kërkesë bazohet në nenet 88 e në vijim të LPP.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimit objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës inxhinierik (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Elektrik
- 3 (tre) inxhinier Informatike/Teknologji-Informacion/Elektronik

Për secilin pjesëtar të stafit inxhinierik të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës, Diplomë, Librezë pune dhe CV.

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr 10. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

Argumentimi Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

Neni 41/4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit”;

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë të punësuar stafin teknik të përbërë nga të paktën 20 (njetë) punonjës të specializuar dhe të certifikuar sipas profesionit që kryejnë dhe të pasqyruar në listë pagesat e shoqërisë për periudhën 3 muajt e fundit, duke marrë si referencë datën e shpalljes së njoftimit të kontratës, me profesione si më poshtë:

- 3 Punonjes te certifikuar me CCNA
- 2 Punonjes te certifikuar me CCNP Enterprise/Service Provider
- 1 Punonjës Menaxher Projekti i certifikuar PMP ose ekuivalent
- 1 Punonjes i certifikuar me CISSP
- 1 Punonjes i certifikuar me ITIL 4

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është percaktuar Në zbatim të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", si dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor ka percaktuar kriteret e veçanta të kualifikimit, të cilat lidhen dhe janë në përpjesëtim me natyrën, objektin, vlerën dhe kompleksitetin e kontratës. Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë minimumi 20 punonjës të specializuar synon të garantojë kapacitetin e nevojshëm njerëzor për realizimin në kohë dhe me cilësi të kontratës, duke siguruar mbulim të plotë të shërbimit, ndërhyrje të menjëhershme, administrim të infrastrukturës dhe ofrim të mbështetjes teknike gjatë gjithë periudhës së kontratës. Kërkesa për: **3 punonjës të certifikuar CCNA** është vendosur për të garantuar disponueshmërinë e specialistëve me njohuri bazë dhe të avancuara në konfigurimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e rrjeteve kompjuterike. **2 punonjës të certifikuar CCNP Enterprise ose CCNP Service Provider** është vendosur për shkak të kompleksitetit të infrastrukturës së rrjetit dhe nevojës për specialistë me kompetenca të avancuara në projektimin, konfigurimin, optimizimin dhe diagnostikimin e rrjeteve të nivelit enterprise dhe service provider. **1 Menaxher Projekti i certifikuar PMP** ose ekuivalent është kërkuar për të garantuar planifikimin, koordinimin, monitorimin dhe administrimin profesional të kontratës gjatë gjithë zbatimit të saj. **1 punonjës i certifikuar CISSP** është kërkuar për të garantuar implementimin dhe administrimin e praktikave më të mira në fushën e sigurisë së informacionit dhe mbrojtjes së sistemeve të komunikimit. **1 punonjës i certifikuar ITIL 4** është kërkuar për të siguruar menaxhimin e shërbimeve IT sipas standardeve ndërkombëtare dhe ofrimin e shërbimit në përputhje me praktikën më të mira të menaxhimit të incidenteve, ndryshimeve dhe vazhdimësisë së shërbimit.*

2.3.4 Çertifikatat që duhet të paraqesin Operatorët Ekonomike:

- ISO 9001:2015 - Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë
- ISO/IEC 27001:2013 - Sistemet e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit
- ISO 22301:2012 - Sistemet e Menaxhimit të Vazhdimësisë së Biznesit
- ISO/IEC 20000-1:2018
- ISO 45001:2018

Nëse çertifikatat janë në gjuhë të huaj, ato të paraqiten të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën zyrtare shqipe. Këto çertifikata të jenë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë çertifikatat e mësipërme sipas natyrës së punës që do të marrë përsipër të realizojë, referuar kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.

Argumentimi Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilët përcaktohet: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **aftësinë teknike dhe profesionale**;...Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë **se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

Në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 përcaktohet: “Autoriteti/enti kontraktor,për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin **çertifikata** të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”

-Certifikatë ISO 9001 - 2015 “Për Sistemin e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalent, mundëson që shoqëria të punojë me standarte e cilësi si dhe mundëson implikimin në menaxhim, identifikimin e riskut dhe mundësive, sigurimin e konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, etj. Kjo kërkesë shërben për të na treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, për të verifikuar dhe garantuar që operatori ekonomik ofertues është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilësore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mirë të cilësisë.

Certifikate 22301 :2012 ISO lidhet me vazhdimësinë e biznesit dhe disponueshmërinë e shërbimit. Dokumenti teknik kërkon SLA me uptime > 99.9%, monitorim të vazhdueshëm, komunikim të sigurt dhe funksionim të qëndrueshëm të kamerave CCTV. Në një sistem monitorimi me 300 kamera, ndërprerjet e gjata ose mungesa e planeve të vazhdimësisë mund të cenojnë funksionin e sigurisë dhe monitorimit. Prandaj, ISO 22301 ose ekuivalent është proporcional me nevojën për të garantuar që operatori ka procedura për menaxhimin e incidenteve madhore, rikthimin e shërbimit dhe ruajtjen e vazhdimësisë operative.

ISO/IEC 20000-1:2018 është e lidhur me menaxhimin e shërbimeve IT/telekom. Dokumenti teknik kërkon monitorim përdorimi, raporte të detajuara, SNMP/NetFlow, kontroll të performancës dhe SLA. Këto elemente kërkojnë menaxhim të strukturuar të shërbimit, përfshirë incident management, problem management, change management, service reporting dhe përmirësim të SLA-ve. Për një sistem me 300 kamera, kërkesa për ISO 20000-1 ose ekuivalent është proporcionale, sepse provon aftësinë e operatorit për të operuar shërbimin në mënyrë të organizuar dhe të matshme.

-Certifikatë ISO 45001-2018 “Për Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë” ose ekuivalent, ose certifikatë e përditësuar **Certifikatë ISO 45001-2023**, mundëson që çdo shoqëri të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, dhe përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet

e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve, hetimin e incidenteve etj.

ISO/IEC 27001:2013 – Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit

E nevojshme për mbrojtjen e dokumentacionit teknik, projektit dhe të dhënave të klientëve dhe përdoruesve, duke siguruar integritetin dhe konfidencialitetin e informacionit gjatë gjithë ciklit të punimeve. kërkesa për certifikatën **ISO/IEC 27001:2013** është e domosdoshme sepse garanton që operatori ka **sistem të menaxhimit të sigurisë së informacionit**, i cili siguron **konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë** e dokumentacionit; Parandalon **aksesin e paautorizuar ose humbjen e të dhënave teknike**, që janë thelbësore për realizimin e projektit.

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të jete i regjistruar dhe i autorizuar/licensuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike që janë objekt i kësaj procedure. Për përmbushjen e këtij kriteri, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dokumentin përkatës (Autorizim) të lëshuar nga AKEP dhe të vlefshëm në datën e dorëzimit të ofertes

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020, neni 73 datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

AK gjykon se kriteri i përcaktuar mbi paraqitjen e Autorizimit të Prodhuesit ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi është në përputhje dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Specifikimet teknike janë hartuar në zbatim të nenit 36 të ligjit nr.162/2020 “ Për prokurimin Publik” dhe nenit 78 pika 2 e VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

NJËSIA E PROKURIMIT

1. _____ 2. _____ 3. _____